



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

**K O R N I Z A
A F A T M E S M E
B U X H E T O R E (KAB) e
K O M U N Ë S S Ë R A H O V E C I T
2015-2017**

Drejtoria për Buxhet dhe Financa

Përmbajtja

I. Hyrje

II. Deklarata e Komunës në lidhje me prioritetet strategjike zhvillimore

III. Korniza Fiskale

3.1 Korniza makroekonomike komunale

3.2 Tendenca e të hyrave komunale dhe parashikimet 2015-2017

3.3 Donatorët e jashtëm

3.4 Politikat e reja

3.3 Tendenca e shpenzimeve komunale dhe parashikimet 2015-2017


IV. Korniza e Përformancës së Shpenzimeve

I. Hyrje

Korniza Afatmesme Buxhetore, KAB, që po prezantohet është një dokument i cili miratohet në parim çdo vit nga Asambleja Komunale. Ky material siguron një analizë të hollësishme të shpenzimeve publike dhe përcakton parametrat dhe prioritetet kryesore për zhvillimin e vazhdueshëm të buxhetit vjetor. Gjithashtu, KAB, siguron mekanizmat e nevojshme, përmes të cilave, objektivat prioritare, të identifikuara në dokumentet strategjike të komunës, aty ku ekzistojnë, të integrohen sa më mirë në procesin buxhetor.

Hartimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore përbën një detyrim për institucionet buxhetore komunale të kërkuar nga Qarkoret Buxhetore Komunale 2015/2017 të pranuar nga Ministria e Financave.

Ky dokument do të jetë baza për përcaktimin e sektorëve prioritarë të zhvillimit dhe identifikimin e prioriteteve të shpërndarjes së burimeve komunale për periudhën 2015-2017. Janë katër faza të përmbledhura për zhvillimin e KAB Komunale dhe afatet kohore, si në figurën e mëposht



II. Deklarata e Komunës në lidhje me prioritetet strategjike zhvillimore

Komuna e Rahovecit gjendet në pjesën jugore të Kosovës, në rajonin Dukagjinmit (Gjegjësisht në subrajoni e Podrimës). Është njëra nga komunat e mesme me popullsi të vendit. Pozita gjeografike që ka i mundëson asaj lidhje të mira me qendrat tjera të Kosovës dhe të rajonit. Komuna e Rahovecit ka gjithsej **35** fshatra. Sipas rezultateve të regjistrimit të popullsisë të vitit 2011, Komuna e Rahovecit ka 56,208 banorë të organizuar në **8.028** ekonomi familjare .

Mbi 2000 biznese operojnë brenda komunës. Bazuar në të dhënat e Zyrës për Regjistrim të Bizneseve në Komunën e Rahovecit, afërsisht gjysma e tyre merren me veprimtari tregtare, 13% në sektorin e shërbimeve, afërsisht 10% në prodhimtari, pjesa tjetër në transport.

Administrata e Komunës së Rahovecit është e organizuar përreth zyrave qendrore dhe zyrave lokale që ofrojnë shërbime në nivel të komunitetit, nga **të cilat dy** janë të vendosura brenda qytetit duke përfshirë zyrën qendrore dhe 8 të tilla në fshatra .

Vizioni i mëposhtëm për Komunën Rahovecit i definuar pas konsultimeve me akterët e rëndësishëm të jetës politike ekonomike e sociale në Komunë bazohet edhe në dokumentet afatmesme dhe afatgjata strategjike, që ka zhvilluar komuna sic janë: në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) 2015-2017 të Qeverisë së Kosovës dhe prioritetëve bazë të saj, si dhe Qarkoret Buxhetore Komunale 2015-2017 (I & __) të lëshuar nga ministria e Financave të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Vizioni i Komunës për tri vitet e ardhshme është për Rahovecin, si një qendër e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik, me urbanizëm modern dhe shërbime efikase e kualitative, i integruar në proceset rajonale dhe ndërkombëtare, si një qendër e kulturës së pasur, arsimimit dhe jetës sportive, me shërbime financiare të zhvilluara dhe ofrimtë një kualiteti të mirë të jetesës për qytetarët e saj.

Atributet më të rëndësishme të çfarëdo dokumenti të planifikimit strategjik dhe vizionit të definduar janë së pari lehtësia e komunikimit si dhe së dyti llogaridhënia. Me qëllim të përmbushjes së këtyre dy attribute binjake prioritet strategjike të Komunës në periudhën afatmesme janë grupuar në katër prioritete që do të mundësojnë realizimin e qëllimit të vizionit tonë për Komunën.

Tre nga këto prioritete kanë të bëjnë me realizimin e objektivave jashtëm ndërsa një prej tyre është i brendshëm dhe kontribuon në zhvillimin e shërbimeve më të mira komunale për qytetarët e Komunës së Rahoveci:

1. Forcimi i Ekonomisë Komunale me mundësi për të gjithë

Rritja e ekonomisë komunale përmes:

- Përmirësimit të standardeve të arsimimit dhe nivelit të arritjes (pajisje shkollore, renovime shkollore dhe permirësim, bursa për studime, laboratore)
- Mbështetjes direkte të sektorit bujqësor dhe blegtorisë

2. Përmirësimi i shëndetësisë dhe mirëqenies së qytetarëve

Krijimi dhe ndihma për qytetarët për të pasur jetë të shëndetshme dhe aktive në komunitetin e tyre:

- Asistenca sociale për familjet në nevojë, pa të ardhura/të ardhura të ulëta
- Përmirësimi i ofrimit të shërbimeve shëndetësore, ofrimi i shëndetësisë mobile
- **Promovimi** i projekteve për rini dhe kulturë, dhe ofrimi i terreneve të reja sportive

3. Përmirësimi i ambientit të Komunës dhe qëndrueshmëria e tij

Absorbimi i popullatës në rritje në komunë dhe njëkohësisht mbrojtja e ambientit përmes:

- Përmirësimi dhe rigjenerimi të infrastrukturës rrugore (sinjalizimi horizontal e vertikal, ndriqimi publik dhe numerizimi); transportit; dhe kanalizimit
- Përmirësimi të standardeve të ambientale
- Ofrimi i më shumë hapësirave të gjelbëruara

Ndërsa prioriteti i fundit strategjik i Komunës ka të bëjë me efikasitetin e brendshëm të qeverisë komunale dhe përmirësimin e ofrimit të shërbimeve për qytetarët e saj.

4. Krijimi i qeverisë komunale që ofron shërbime efikase dhe që u përgjigjet kërkesave të qytetarëve

Përmirësimi i shërbimeve komunale karshi qytetarëve duke u fokusuar qasjen më të afërt dhe të lehtë të tyre në administratë përmes:

Ndërtimit dhe rekonstruimit të zyreve komunale (të gjendjes civile) në pika më të afërta të vendbanimeve, më qëllim të ofrimit të shërbimeve

Katër fushat prioritare të komunës dhe objektivat e saj për periudhën afatmesme 2015-2017 do të shoqërohen me një miks të hyrash dhe shpenzimesh në të pesë kategoritë ekonomike të cilat do të mund të monitorohen dhe raportohen karshi arritjeve.

III. Korniza Fiskale Komunale

3.1 Ndonëse komuna nuk udhëheqë drejtpërdrejt politikën makroekonomike (kjo është kompetencë e qeverisë qendrore) mjedisi i përgjithshëm ekonomik ndikon në pasqyren fiskale komunale dhe si i tillë do të trajtohet si vijon, shih tabelën më poshtë. Korniza Afatmesme Buxhetore e Komunës është në përputhje me kornizën makroekonomike të Kosovës dhe sipas dokumentit Korniza Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) 2015-2017 të përpiluar nga Qeveria e Kosovës.

Komponentët e politikës makroekonomike sic janë Bruto Produkti Vendor, inflacioni dhe demografia duhet konsideruar dhe marrë parasysh. Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2015-2017 e Qeverisë së Kosovës bazuar në të dhënat historike si dhe në zhvillimet e fundit ekonomike, nënvizon faktin se do të ketë ecuri pozitive të rritjes

ekonomike në vitet e ardhshme, më saktësisht në periudhën 2015-2017 parashihet një rritje reale vjetore 5.6 % në vitin 2015, ndërsa rritja reale e Bruto Produktit të Vendit në 2016 dhe 2017 parashihet të jetë 5.8 % respektivisht 5.8 %.

Natyrisht se rritja ekonomike ndryshe përkthehet edhe në krijimin e vendeve të reja të punës dhe zbutjen e papunësisë në Komunë, që në periudhën afatmesme ulet me 2.0 %, nga niveli i përgjithshëm i papunësisë që llogaritet të jetë i lartë.

Komuna nga ana e saj do të adaptojë legjislacionin përkatës në funksion të krijimit të ambientit më të mirë për sektorin privat dhe rritjes së të ardhurave të tyre, rrejdhimisht rritjes së të hyrave buxhetore komunale.

Aktualisht financimi komunal përfshinë:

1. Të Hyrat Vetanake dhe
2. Grandet Operative.

Komuna në periudhën afatmesme buxhetore 2015-2017 nuk planifikon të marrë hua nga institucione financiare për të financuar projektet e saj, sic e ka lejuar Ligji për Financat Publike dhe Llogaridhënie.

Tabela 1: Indikatorët ekonomik komunal


Përshkrimi	2014	2015	2016	2017 (vlerësim)
Indikatorët makroekonomik në Kosovë				
Rritja reale e BPV në %	4.4	5.2	5.25	5.3
Inflacioni në %	1.1	2	2	2
BPV për kokë banori, në euro	4.5	4.6	4.2	4.1
Indikatorët ekonomik komunal				
Popullsia e Komunës	56.208	56.208	56.208	56208
Numri i bizneseve të regjistruara	2.000	2150	2200	2200
Numri i nxënësve	12.871	12.871	12.850	12.795

Burimi: Korniza Afatmesme e Shpenzimeve, Qeveria e Kosovës, 2015-2017

3.2 Tendencat e të hyrave komunale dhe parashikimi afat-mesëm 2015-2017

Të hyrat e Komunës së Rahovecit nga dy burimet e saj kryesore – grantet qeveritare si dhe të hyrat vetanake komunale kanë shënuar rritje nga viti në vit.

Figura 1: Buxheti Total i Komunës në vite (2015 – 2017), milion Euro:



Në bazë të planifikimit të bërë nga viti 2014 grantet qeveritare për Komunën e Rahovecit si tërësi do të shënojnë rritje graduale. Rritja e granteve qeveritare do të jetë përafërsisht 7.00 -14.42 % në krahasim me vitin 2014 sipas të dhënave të prezantuara në tabelën më poshtë, kjo rritje kryesisht bazohet në të dhënat e përgjithshme për rritjen buxhetore që planifikohet në nivel të Qeverisë nacionale, sic parashihet me KASH-in 2015-2017. Rritja kryesisht është reflektuar në Grantin e Përgjithshëm të Komunës (shih më poshtë tabelën 2)

Të hyrat vetanake komunale, në anën tjetër, kanë shënuar rritje të ndjeshme nga viti në vit po ashtu. Të hyrat vetanake të planifikuara rriten nga viti 2015-2017 përafërsisht 10.18 – 11.57 % në krahasim me vitin 2014 . Kjo rritje kryesisht është koncentruar në të hyrat nga tatimi në pronë ku norma tatimore për 2015-2017 ka rritje në bazë të legjislacionit në fuqi, duke llogaritur gjithcka tjetër njëjtë. Realisht nëse shikojmë planifikimin nga viti 2014 deri në vitin 2015 rritja e të hyrave të planifikuara nga tatimi në pronë do të jetë për 12.5 %.

Tabela 2: Planifikimi i të hyrave vetanake komunale sipas burimit për periudhen 2015-2017, në euro

Komuna: RAHOVEC		Grantet dhe THV – 2014	Grantet dhe THV – 2015	Grantet dhe THV – 2016	Grantet dhe THV - 2017
		në Euro	në Euro	në Euro	në Euro
Burimet e të Ardhurave					
0	GRANTET	9.774.525	11.174.300	11.330.193	11.502.468
	Granti i Përgjithshëm	3.461.433	4.332.840	4.327.758	4.368.014
	Granti i Arsimit	4.287.738	4.413.520	4.457.552	4.478.992
	Granti i Shëndetësisë	1.075.354	1.328.926	1.386.869	1.418.446
	Shtesa sipas QB 2015/02		264.401		

Planifikimi i të Hyrave Vetanake Komunale për vitin 2015 - 2017

RAHOVEC		THV - 2015	THV - 2016	THV - 2017
		në Euro	në Euro	në Euro
Nr.ren.	Burimet e të Ardhurave	Totali	Totali	Totali
I-A.	TË ARDHURAT E ADMINISTRATËS KOMUNALE - Direkte			
1	Liçensat komerciale dhe të biznesit / Lejet	165,000	175,000	184,000
1.1.	Funksionimet e dyqaneve të mëdha dhe shërbimeve tjera	75,000	78,000	80,000
1.2.	Funksionimet e aktiviteteve industriale ose aktiviteteve të lidhura me ndërtimin	35,000	37,000	39,000
1.3.	Funksionimi me shitore në rrugëose afër rrugëve,kiosqe,karroca të vogla lëvizëse	18,000	20,000	22,000
1.4.	Funksionimet e bankave,bashk.të sigurimit dhe shërbimeve tjera financiare	12,000	13,000	14,000
1.5.	Funksionimet e Gurëthyesve,minierave	25,000	27,000	29,000
2	Liçensat për lojra zbavitëse,pije alkoolike,reklamime,shpallje etj. / Lejet	6,000	7,000	8,000
2.1.	Funksionimet me makina me monedha ose me lojra dh të ngjajshme			
2.2.	Funksionimet dhe vendosja e shërbimit të pijeve alkoolike			
2.3.	Reklamimi, publikimi në pronën Komunale	6,000	7,000	8,000
3	Liçensat profesionale / Lejet	10,000	11,000	12,000
3.1.	Funksionimi i shërbimeve profesionale (.Avokatët,Mjekët,Dendistet, etj.)	10,000	11,000	12,000
4	Shfrytëzimi i Tokës dhe Lejet e ndërtimit	90,000	93,000	95,000
4.1.	Lejet për ndërtim dhe konstruktive	55,000	58,000	60,000
4.2.	Pagesat e ndërrimit të destinimit të tokës ekzistuese	10,000	10,000	10,000
4.3.	Pagesat e demolimit			
4.4.	Pagesat me ndikim nga shfrytëz.i madh i rrugëve publike apo i shërb.publ.të siguruar për ndërtim ose operim komerc. duke përfshirë edhe vendet e nxjerrjes se resurseve nat.			
4.5.	Tatimet nga nxjerrja e Resurseve natyrore(Neni 10.5 CFA Udhëzim Ad...Nr.2001/03 dhe 2015/16 DLA)	25,000	25,000	25,000
5	Inspektimi i tokës dhe aktivitetet Gjeodezike	55,000	56,000	57,000
5.1.	Përgatitja e plan.urban.dhe inspekt.që kanë të bëjë me dimensionet e pronës			
5.2.	Aktivitetet në teren që kanë të bëjë me matjen e vendit	55,000	56,000	57,000
6	Shërbimet e inspektimit të Shëndetit dhe Sigurisë	34,000	36,000	38,000
6.1.	Inspektimi i objekteve që ofrojnë ushqim dhe akomodim publik	12,000	14,000	14,000
6.2.	Inspektimi i ambientit	12,000	12,000	12,000
6.3.	Inspektimi i ndërtimit,shërbimit të zjarrfikësve dhe konstruktimit	10,000	10,000	12,000
7	Shfrytëzimi i pronës Komunale	67,000	73,000	77,000
7.1.	Baza ditore apo bazat tjera për shfrytëzimin e pronës publike për aktivitetet komerciale apo jo komerciale	30,000	32,000	33,000
7.2.	Ngarkesat për hapsirë në tregje ose në objekte të ngjajshme	2,000	4,000	6,000
7.3.	Marrja me qira e objekteve komunale për një afat të gjatë	35,000	37,000	38,000
7.4.	Të hyrat nga shitja e pronës komunale			
8	Pagesat në lidhje me Automjetet	135,000	146,000	140,000
8.1.	Lejet e automjeteve			
8.2.	Parkimi në parkingun publik I paisur me garazhim apo hapsira tjera			
8.3.	Gjobat në trafik			
8.4.	Largimi dhe deponimi I automjeteve			
8.5.	Regjistrimi i automjeteve	135,000	146,000	140,000

9	Çertifikatat dhe Dokumentet Zyrtare	102,014	116,014	131,014
9.1.	Pagesat e regjistrimit të pronës dhe të transferit	40,000	47,000	56,000
9.2.	Dokum.lidhur me statusin shoqëror si dhe të lindjes,vdekj,martesës,shkurorizimit	18,000	20,000	21,000
9.3.	Pagesat për kopjet shtesë të çertifikatave/dokumenteve	14,000	16,000	18,000
9.4.	Taksa administrative	16,000	18,000	20,000
9.5.	Të tjera	14,014	15,014	16,014
10	Taksa e pronës	320,000	330,000	340,000
10.1.	Pagesat e taksës së pronës	320,000	330,000	340,000
11	Të ardhurat tjera	3,000	5,000	6,000
11.0.	Përfitimi nga privatizimi			
11.1.	Regjistrimi i Biznesit -			
11.2.	Të hyrat nga kontestet e komunes			
11.3.	Gjobat tjera	3,000	5,000	6,000
11.4.	Pagesat tjera			
I-A.	Nëntotali I-A , Të ardhurat direkte (Tarifat dhe ngarkesat)	987,014	1048,014	1,088,014
1.0.	Denimet në komunikacion,të grumbulluara përmes Nivelit Qendror (ShPK)	54,000	58,000	59,000
1.1.	Të tjera			
I - B.	Nëntotali I-B , Të ardhurat indirekte (Pjesa që i takon komunave)	54,000	58,000	59,000
I	Totali I Administrates komunale (Direkte dhe Indirekte & IA+IB)	1039,014	1,098,014	1,147,014
	TË ARDHURAT NGA ARSIMI			
1	Qerdhet	10,000	10,000	10,000
2	Arsimi parashkollor			
3	Arsimi fillor			
4	Arsimi i mesëm			
5	Mësimi joformal			
6	Të tjera			
II	Totali - Arsimi	10,000	10,000	10,000
	Të ARDHURAT NGA SHËNDETËSIA			
1	Shëndetësia primare	50,000	50,000	50,000
2	Të tjera			
III.	Totali - Shëndetësia	50,000	50,000	50,000
Kodi 21	TOTALI I TË ARDHURAVE VETANAKE TË KOMUNES (I+II+III):	1,099,014	1,158,014	1,207,014
IV.	Donatorët e mbrenshem (IV)			
1.1	Participimi I popullates			
1.2	Grantet e donatorve te mbrendshëm (ministritë apo të tjerë)			
1.3	Të hyrat dhe donacionet tjera			
1.4	Tjera			
Kodi 31	Total (IV)	-	-	-
V	Donatorët e Jashtëm (V)			
	Gjithsej të ardhurat e komunës (I+II+III+IV)	1,099,014	1,158,014	1,207,014

Komuna e Rahovecit vazhdon të dominohet në buxhetin total të saj nga transferet qeveritare të cilat edhe në tri vitet e ardhshme do të përbëjnë afërsisht 90.16 % të buxhetit total të komunës.

3.2.1 Donatorët e jashtëm (ndërkombëtarë)

Vlera totale e financimit të donatorëve të jashtëm në realizimin e projekteve të ndryshme për Komunën, gjatë vitit 2014 është _____ (sipas tabelës 3) që ndryshe reprezenton ____% të buxhetit total të Komunës së Rahovecit për vitin 2014.

Tabela 3: Të hyrat nga donatorët e jashtëm për vitin 2014

Totali	

Komuna nuk ka të planifikuar donacione të jashtme meqë nuk ka marrëveshje të nënshkruar me ta eventualisht zotime paraprake.

3.2.2 Politikat e reja

Komuna e Rahovecit në tri vitet e ardhshme do të bëjë përpjekje në mobilizimin e resurseve komunale me qëllim të adoptimit të politikave të reja që ka inicuar qeveria nacionale e Republikës së Kosovës, por edhe të atyre të inicuar në nivelin e qeverisë komunale.

Fillimisht, ndonëse ende nuk është pjesë e Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve të Qeverisë së Kosovës 2015-2017, sygjerimit të Qeverisë së Kosovës janë që shuma e Grantit të Përgjithshëm të komunave që aktualisht është dhjetë përqind (**10%**) e të hyrave totale të buxhetuara të Qeverisë qendrore, (duke përfshirë të hyrat nga shitja e aseteve, të hyrat tjera të jashtëzakonshme, të hyrat e dedikuara vetanake dhe të hyrat nga huamarrja) do të reduktohet në **8%**, në vitet e ardhshme. Projektionet e bëra për 2015 dhe 2016 në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve të Kosovës, nuk reflektojnë ende këtë politikë. Për Komunën e Rahovecit kjo do të vazhdojë të jetë një risk që duhet trajtuar në të ardhmen dhe menduar strategjitë që duhet ndjekur me qëllim të mbulimit të asaj difference që do të shkaktonte ulja e nivelit të grantit të përgjithshëm, për komunën.

Së dyti, në rast se në periudhën afatmesme Qeveria e Kosovës do të ndryshojë formulën shtetërore të ndarjes së grantit të arsimit për Komuna, ndarje kjo që pretendohet të bëhet në bazë të normës e jo të numrit të nxënësve, atëherë kjo do të ketë ndikim të dukshëm në buxhetin e Komunës, ulë grantin e arsimit, sidomos pas parasysh se ky grant përbën pjesën më të madhe të buxhetit komunal. Komuna nuk ka informatat e nevojshme për të bërë analizën e impaktit të kësaj politike.

Së treti, Komuna e Rahovecit ndonëse me informata të limituara do të jetë e ndikuar në aspektin buxhetor edhe me rastin e fillimit të aplikimit të Ligjit për gradim në paga për shërbyesit civil të Kosovës, ndonëse ende nuk është bërë

ndonjë analizë në lidhje me ndikimin fiskal apo buxhetin e Komunës. Tutje, Komuna nuk posedon me informatat e nevojshme për të bërë këtë analizë, të cilën në të ardhmen ndoshta do ta ofronte Ministria e Administratës Publike.

Së katërti, sa i përket politikave të reja ose atyre të paralajmëruara nga niveli qendror, me ndikim në Komunën e Rahovecit, është edhe politika që do të zgjedhet nga viti 2015 e tutje, në lidhje me trajtimin e mirëqenies sociale si kompetencë e decentralizuar në komunat e Kosovës. Komuna e Rahovecit aktualisht nuk posedon informatat e nevojshme në lidhje me mënyrën e ndarjes buxhetore që do të bëhet për financimin kësaj fushe, ndryshe nga ajo që është aktualisht, ndonëse ka paralajmërime nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Ministria e Financave sa i përket këtyre politika.


Së pesti, Komuna e Rahovecit ka mirëprit deklarimet e Qeverisë Nacionale, që në të ardhmen, sa i përket fleksibilitetit të shpenzimeve në të gjitha kategoritë ekonomike, përveç pagave, të kenë mundësi këtë ta bëjnë edhe nga Granti i Përgjithshëm si shtesë, përveq se nga të hyrat vetanake komunale.

Ndërsa sa i përket të hyrave të tjera të Komunës, apo të hyrave vetanake, sërish qeveria nacionale ka shtyrë drejt politikave të reja që do të orientonin komunën drejt avancimit të tatimeve me potencial të mirë dhe zbehjes eventualisht eliminimit të atyre taksa e ngarkesa komunale që rëndojnë ambientin biznesor komunal, janë jo transparente dhe fer, karshi qytetarëve respektivisht tatimpaguesit komunal.

3.3 Tendenca e shpenzimeve komunale dhe parashikimi i tyre afat-mesëm 2015-2017

Sipas rekomandimeve të Misionit të Fondit Monetar Ndërkombëtar të komunikuara përmes Qarkores Buxhetore komunale 2015 komunat do të kenë edhe në të ardhmen fleksibilitet në shpërndarjen e të hyrave vetanake komunale në strukturën e shpenzimeve sipas kategorive ekonomike për vitin 2015, duke përjashtuar kategorinë Paga dhe Mëditje. Si rezultat Komuna e Rahovecit prezanton këtë ndarje të shpenzimeve në mes të kategorive të lejuara buxhetore:

Figura 2: Shpenzimet komunale në kategori ekonomike, 2015-2017



3.3.1 Pagat dhe Mëditjet – Gjatë vitit 2015 krahasuar me vitin 2014, kjo kategori e shpenzimeve pritet të rritet 25.8 % si rezultat i vendimit të qeverisë për rritjen e pagave 25 % . Kjo kategori e shpenzimeve gjatë periudhës 2015-2017 pritet të rritet me një mesatare vjetore prej 25 % bazuar në KASH-in e Qeverisë së Republikës së Kosovës. Rritja me e lartë prej rreth 8% në këtë kategori pritet të ndodhë gjatë vitit 2015, si rezultat i implementimit të legjislacionit sekondar që ka të bëjë me reformën në administratën publike, ndërsa për vitet vijuese kjo kategori pritet të rritet ndjeshëm. Pjesëmarrja e kategorisë së pagave dhe mëditjeve në shpenzimet përgjithshme buxhetore komunale, gjatë këtyre viteve, pritet të mbetet në nivel të përafërt **56.00 %**.

3.3.2 Mallrat dhe Shërbimet - kategoria e shpenzimeve për mallra dhe shërbime (duke përfshirë komunalitetë), është zbritur për 1.01 % nga viti 2014 në vitin 2015 dhe tutje. Është një rritje e konsiderueshme e kësaj kategorie e cila kryesisht i atribuohet rritjes së shpenzimeve për mirëmbajtjen e projekteve (të reja) kapitale shkollave, punkteve shëndetësore, objekteve sportive etj) si dhe rritjes së nevojave për material shpenzues (lëndë djegëse dhe karburante në proporcion me zgjerimin sipërfaqeve të objekteve të reja). Pjesëmarrja e kësaj kategorie të shpenzimeve në shpenzimet e përgjithshme buxhetore, gjatë këtyre 3 vite të ardhshme pritet të jetë mesatarisht **9.00 %**.

3.3.3 Subvencionet –Në 2014 subvencionet që do të ofrohen janë për bujqësi, shëndetësi (shpërndarja e ilaçeve shtesë nga lista esenciale që shpërndanë MSH si dhe ndihmë për shërim jashtë vendit bazuar në kërkesat e deponuara),kulturë e përgjithshme buxhetore gjatë viteve 2015-2017mesatarisht do të jetë **1.00 %**.

3.3.4 Investimet Kapitale - kjo kategori e shpenzimeve do të shënojë rritje në vitin 2015, për 1.23 % krahasuar me vitin 2014 . Një pjesë e madhe e tyre planifikohet të financohet nga të hyrat vetanake të komunës. Rritja në investimet kapitale, nga buxheti i komunës do të përmirësohet nga viti në vit, mirëpo edhe në vitin 2015 do të vazhdojë të jetë më e lartë nga aktualja. Pjesëmarrja e investimeve kapitale në totalin e shpenzimeve të komunës në vitin 2015 dhe tutje pritet të jetë mesatarisht: **33.00 %**.

Tabela 6: Korniza Buxhetore Komunale, në euro

	Përshkrimi	2014 (buxheti aktual)	2015 (plani)	2016(vlerësi met)	2017(vlerësimet)
1.	TË HYRAT TOTALE KOMUNALE	9.774.525	11.438.701	11.330.193	11.502.468
1.1	Të hyrat vetanake	950.000	1.099.014	1.158.014	1.207.014
1.2	Grantet dhe transferet qeveritare	8.824.525	10.339.687	10.172.179	10.295.454
2.	SHPENZIMET TOTALE KOMUNALE	9.774.525	11.438.701	14.330.193	14.502.468
2.1	Shpenzimet rrjedhëse	6.456.525	7.707.991	7.70.991	7.707.991
	Pagat dhe mëditjet	5.365.372	6.606.800	6.606.800	6.606.800
	Mallrat dhe shërbimet	733.893	656.191	656.191	656.191
	Shpenzime komunale	257.260	295.000	295.000	295.000
	Subvencionet	100.000	150.000	150.000	150.000
2.	Shpenzimet Kapitale	3.318.000	3.730.710	4.622.202	3.794.468
	SUFICIT / DEFICIT	0			
	Nga të cilat: Grantet e jashtme për projekte kapitale				
3.	BILANCI PRIMAR BUXHETOR				
3.1	Pagesa e interesit për borxhin e jashtëm				
4.	BILANCI TOTAL BUXHETOR				
5.	FINANCIMI				
5.1	Financimi i jashtëm				
	Ripagimi i borxhit kryesor				
	Huamarrja e jashtme				
5.2	Financimi i brendshëm				
	Shitja e aseteve				
	Huamarrja e brendshme				
	Ndryshimi në fitimet e pashpërndara				
6.	BILANCI BANKAR NË FUND TË VITIT				

Tabelat në vijim janë një pasqyrë e shpërndarjes së shpenzimeve komunale në bazë të programeve apo kategorive funksionale si dhe në bazë të kategorive ekonomike. Shpenzimet në vijim janë ato aktualet të vitit 2014, planifikimi për vitin e ardhshëm 2014 si dhe projeksionet e vitit 2016-2017.

Tabela 7: Shpenzimet Komunale 2014, të shpërndara në kategori ekonomike dhe programe

	2014					
	Prog Paga/Meditje rrethet	Mallra/Sherbime	Shpenzime komunali	Subvencione	Shpenzime Kapitale	Gjithsej
Zyra e Kryetari	85.460	36.2080	0	0	0	120.868.
Zyra e Kuvendit komunal	100.850	8.000	0	0	0	209.850
Administrata dhe Personeli	175.460	36.700	0	0	73.000	285.180
Inspektimet	50.286	14.850	0	0	0	65.116
Buxhet dhe financa	66.260	24.450	0		25.000	115.710
Infrastruktur Publike	121.550	26.150	120.750	0	1.774.800	2.042.450
Zyra Komunale per Komunitet	28.130	16.500	1.5600	0	30.000	78.130
Bujqësi, Pyltari dhe Zhvillim Rural	41.015	13.540	0	0	415.555	470.110
Zhvillim Ekonomik	26.350	13.520	0	0	10.000	58.870
Kadastra dhe Gjeodezia	48.260	13.000	0	0	20.000	81.200
Planifikimi Urban dhe Mjedis	33.152	13.922	0	0	515.000	562.074
Shëndetësi						
Administrata						
Shërbimet e shëndetësis primare	651.7740	172.620	50.000	70.000	194.984	1.138.354
Sherbimet Sociale	61.015	13.000	4.500	0	0	78.520
Kulturë, Rini dhe Sport	42.015	18.780	0	30.000	160.000	251.715
Arsim dhe shkencë						
Administrata	32.256	80.003	0	0	91.451	183.710
Arsimi parashkollor	27.264	16.000	5.253	0	0	48.517
Arsimi fillor	3.105.003	181.230	60.157	0	0	3.346.390
Arsimi i mesem	668.521	57.500	15.100	0	0	741.121
GJITHSEJ	5.365.372	733.893	257.260	100.000	3.318.000	9.774.525

Tabela 8: Shpenzimet Komunale për 2015, të shpërndara në kategori ekonomike dhe programe

Drejtoritë/Programet	Drejtoritë/Programet	Numri i puntoreve	Pagat	Mallra dhe shërbime	Shpenzime komunale	Subvencione	Shpenzime kapitale	Gjithësejt €
Zyra e Kryetari			100.760	25.627	0	70.000		196.387
Zyra e Kuvendit komunal			100.840	13.500	0	0	0	114.340
Administrata e përgjithëshme			226.760	41.592	0	0	68.866	337.218
Inspeksioni			59.090	10.822	0	0	35.000	104.912
Buxhet dhe financa			78.840	15.742	0	0	25.000	119.582
Shërbimet Publike			28.886	10.000	145.000	0	1.700.000	1.883.886
Drejtroia per mbrojtje dhe shpetim			123.064	14.000	0	0	0	137.064
Zyra e komuniteteve			34.390	10.3090	0	0	32.000	76.699
Bujqësi dhe Pyltari			49.760	10.000	0	0	458.000	517.760
Zhvillim Ekonomik			36.200	8.000	0	0	63.254	107.454
Kadastër ,Gjeodezi ,Pronë			58.290	13.000	0	0	80.000	151.290
Urbanizëm dhe mbrojtje të mjedisit			40.610	12.000	0	0	488.103	540.713
Shëndetësia								
DSHMS			835.295	165.0090	60.000	50.000	268.631	1.378.926
QKMF								
QPS			77.540	9.000	5.600	0	50.000	141.540
Kulturë, Rini dhe Sport			52.410	15.000	0	30.000	161.856	259.266
Arsim dhe shkencë								
DKA			39.230	8.000	0	0	300.000	347.230
Arsimi parashkollor dhe qerdhet			33.538	11.700	5.600	0	0	50.838
Arsimi fillor			3.648.669	180.479	60.800	0	0	3.889.9489
Arsimi I mesem			982.628	82.420	18.600	0	0	1.083.648
Gjithësejt €			6.606.800	656.191	295.0003	150.000	3.730.710	11.438.701

Kur i marrim burimet e financimit që i ka arsimit del se nuk ka mjete të mjaftueshme për financim. Nga vetë tabela e paraqitur më lartë shihet se fondi i pagave i cili është i paraqitur (për bazë është marrë paga e Prillit dhe e Majit 2014), Këtu nuk është llogaritur rritja e pagave për vitin 2015 si dhe janë marrë planifikimi vetëm për 10 lehonat që ka nevojë arsimit për të zëvendësuar dhe licencimet që bëhen në arsimit është llogaritur një mesatare.

Tabela 9: Shpenzimet Komunale, projeksionet 2016-2017, të shpërndara në kategori ekonomike dhe programe

Drejtoritë/Programet	Drejtoritë/Programet	Numri i puntoreve	Pagat	Mallra dhe sherbime	Shpenzime komunale	Subvencione	Shpenzime kapitale	Gjithësejt €
Zyra e Kryetari			100.760	25.627	0	70.000		196.387
Zyra e Kuvendit komunal			100.840	13.500	0	0	0	114.340
Administrata e përgjithëshme			226.760	41.592	0	0	51.0000	319.352
Inspeksioni			59.090	10.822	0	0	35.000	104.912
Buxhet dhe financa			78.840	15.742	0	0	12.000	109.582
Shërbimet Publike			28.886	10.000	145.000	0	1.800.571	1.984.457
Drejtproia per mbrojtje dhe shpetim			123.064	14.000				137.064
Zyra e komuniteteve			34.390	10.309	0	0	40.000	84.699
Bujqësi dhe Pyltari			49.760	10.000	0	0	357.000	416.760
Zhvillim Ekonomik			36.200	8.000	0	0	48.000	92.200
Kadastër ,Gjeodezi ,Pronë			58.290	13.000	0	0	90.000	161.290
Urbanizëm dhe mbrojtje të mjedisit			40.610	12.000	0	0	462.057	534.667
Shëndetësia								
DSHMS			835.295	165.009	60.000	50.000	326.574	1.437959
QKMF								
QPS			77.540	9.000	5.600	0	50.000	141.540
Kulturë, Rini dhe Sport			52.410	15.000	0	30.000	150.000	247.410
Arsim dhe shkencë								
DKA			39.230	8.000	0	0	200.000	247.230
Arsimi parashkollor dhe qerdhet			33.538	11.700	5.600	0	0	50.838
Arsimi fillor			3.648.669	180.479	60.800	0	0	3.889.9489
Arsimi I mesem			982.628	82.420	18.600	0	0	1.083.648
Gjithësejt €			6.606.800	656.191	295.0003	150.000	3.622.202	11.330.193

Drejtoritë/Programet	Drejtoritë/Programet	Numri i puntoreve	Pagat	Mallra dhe shërbime	Shpenzime komunale	Subvencione	Shpenzime kapitale	Gjithësejt €
Zyra e Kryetari			100.760	25.627	0	70.000		196.387
Zyra e Kuvendit komunal			100.840	13.500	0	0	0	114.340
Administrata e përgjithëshme			226.760	41.592	0	0	51.000	319.352
Inspeksioni			59.090	10.822	0	0	35.000	104.912
Buxhet dhe financa			78.840	15.742	0	0	12.000	109.582
Shërbimet Publike			28.986	10.000	145.000	0	1.684.846	1.868.732
Drejtroia per mbrojtje dhe shpetim			123.064	14.000				137.064
Zyra e komuniteteve			34.390	10.309	0	0	40.000	84.699
Bujqësi dhe Pylltari			49.760	10.000	0	0	450.000	509.760
Zhvillim Ekonomik			36.200	8.000	0	0	49.000	93.200
Kadastër ,Gjeodezi ,Pronë			58.290	13.000	0	0	110.000	181.290
Urbanizëm dhe mbrojtje të mjedisit			40.610	12.000	0	0	610.480	663.090
Shëndetësia								
DSHMS			835.295	165.009	60.000	50.000	358.151	1.468.455
QKMF								
QPS			77.540	9.000	5.600	0	50.000	141.540
Kulturë, Rini dhe Sport			52.410	15.000	0	30.000	160.000	257.410
Arsim dhe shkencë								
DKA			39.230	8.000	0	0	184.000	231..230
Arsimi parashkollor dhe qerdhet			33.538	11.700	5.600	0	0	50.838
Arsimi fillor			3.648.669	180.479	60.800	0	0	3.889.9489
Arsimi I mesem			982.628	82.420	18.600	0	0	1.083.648
Gjithësejt €			6.606.800	656.191	295.0003	150.000	3.794.477	11.502.468

Kategoria Ekonomike – Investimet Kapitale - e prezantuar në detaje më poshtë paraqet një komponentë të rëndësishme të buxhetit të komunës e cila ndonëse nuk përfaqëson pjesën më të madhe të shpenzimeve të përgjithshme buxhetore, mbetet me rëndësi të posaçme në aspektin e planifikimit, për Komunën e Rahovecit. Kjo kategori e shpenzimeve në kuadër të shpenzimeve të rregullta buxhetore, ka potencialin më të madh për të nxitur rritjen ekonomike. Andaj, kjo kategori e shpenzimeve, edhe gjatë periudhës së ardhshme afatmesme, do të vazhdojë të jetë në funksion të krijimit të ambientit më të favorshëm për ngritje të pjesëmarrjes së sektorit privat, përmes përmirësimit të vazhdueshëm të infrastrukturës. Përderisa ndikimi i këtyre investimeve në punësim dhe konsum është relativisht i shpejtë, ndikim i plotë i tyre në ekonomi do të mund të realizohet vetëm në periudhën afatmesme. Në këtë kontekst përmirësimi i infrastrukturës do të pozicionojë ekonominë e Komunës së Rahovecit në një rrugë të rritjes më të shpejtë dhe të qëndrueshme ekonomike në periudhën afatgjatë.

Tabela 10: Projektet Kapitale të komunës 2015-2017, dhe kostoja e asociuar me to në Euro